Kronikë

Tiranë/ Tritol në banesën e një punëtori ndërtimi! Policia: Banesa e marrë me qira, po hetohet dhe pronari

Banorët e Laprakës u tronditën mesnatën e së shtunës pas një shpërthimi të ndodhur në banesën ku jetonte një punëtor ndërtimi. Policia thotë se banesa është marrë me qira nga 34 vjeçari, ndërsa po hetohen edhe pronarët të cilët jetojne në Francë.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
22 Janar, 10:03 | **Përditesimi: 22 Janar, 14:24**

TIRANË - Një sasi e vogël eksplozivi është hedhur në mesnatë në shtëpinë e një punëtori ndërtimi në kryeqytet. Policia bëri me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 00:05, në rrugën "Ndoc Martini", në zonën e Laprakës.

Sasia e vendosur në verandën e banesës së Demir Carës mësohet se është një kallëp me 30 gramë tritol. Nga shpërthimi fatmirësisht nuk ka patur të lënduar por janë shkaktuar vetëm dëme materiale. Banorët e zonës shprehen se janë alarmuar nga ngjarja.

LEXO EDHE:
Partia e Lirisë: Qeveria do j' u prishë pronat banorëve të Berxullë duke i ofruar kompensime qesharake! Anti-kushtetuese! Të tërhiqet menjëherë

Nuk dihet nëse 34-vjeçari ka konflikte me persona të tjerë, por mësohet se banesa ishte marrë me qera prej tij që prej 1 viti. Nga ana tjetër mësohet se pronarët e banesës jetojnë në Francë.

Qiramarrësi ka deklaruar në polici se nuk ka konflikte me njeri. Blutë e kryqytetit dyshojnë se lënda plasëse mund te jetë vendosur si kërcënim ndaj familjarëve të pronarëve të ndërtesës por është duke u hetuar edhe qeraxhiu Demir Cara.

Në përditësim...

A.M./KT/Shqiptarja.com

TAG: Tiranë | demir cara | tritol

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
12 vite nga vrasjet në bulevard, a është bërë drejtësi për 21 janarin?

PO | JO | NUK E DI

Lajme të tjera

Shpërndanin lëndë narkotike ekstazi në zona të ndryshme të Tiranës, 3 të rinj në pranga! Në kërkim bashkëpunëtori
22 Janar, 10:39

U arrestua për instalimin e matësve të energjisë elektrike, zbulohet shuma e parave që elektricisti i OSHEE-së u merrte qytetarëve në Tiranë
22 Janar, 10:36

Kujdes nga profilet e rreme të vajzave në Instagram! Djemtë shtiren me foto provokuese, denoncimi i italianit: Pagova 1300 euro për shërbime seksi
Sokol Dema
21 Janar, 16:53

Përvetësonin mjete të qytetarëve duke i mashtruar dhe i shisnin me kontrata false, në pranga 38-vjeçari në Tiranë! Në kërkim bashkëpunëtori i tij
21 Janar, 11:01

Erion Braçe: Si u pushkatuan 12 vite më parë Ziver Veizi, Hekuran Deda, Faik Myrtaj dhe Aleks Nika
Erion Braçe
21 Janar, 10:37

U instalonte matës të energjisë elektrike disa personave në Tiranë dhe u merrte para, arrestohet punonjësi i OSHEE-së
21 Janar, 10:33

Zbardhen 6 vjedhje në banesa dhe biznese në Kavajë, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 30-vjeçari
21 Janar, 09:53

Vodhi 15 mijë euro, 180 mijë lekë e bizhuteri me vlerë nga disa banesa, arrestohet 32-vjeçari në Tiranë
20 Janar, 15:22

Veliaj merr titullin 'Qytetar Nderi' i Preshevës: E pranoj me shumë përulësi këtë nderim të madh! Tirana do të financojë rikonstruksionin e shkollës 'Dituria'
20 Janar, 14:09

Mbanin të fshehur armë zjarri në magazinën e lokalit, në pranga babë e bir në Tiranë (EMRAT)
20 Janar, 13:24

Tentuan të kalonin kufirin me dokumente të falsifikuara, arrestohen tre turq në Rinas
20 Janar, 08:56

VIDEO/ Drejtonte pa patentë 'Audin', me shpejtësi 216 km/h, vihet në pranga 18-vjeçari
19 Janar, 18:10

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje